



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT DHE BORXHIT PUBLIK
DREJTORIA E ANALIZAVE DHE PROGRAMIMIT BUXHETOR

UDHËZIM PLOTËSUES

09/07/2018

3535/73

Nr. 7/2 Datë 09.07.2018

“PËR
PËRGATITJEN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2019-2021”

Në përputhje me Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 neni 27, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe nënçështjes 3.2, pika 1 e Udhëzimit nr.7 datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, Ministri i Financave dhe Ekonomisë;

UDHËZON:

1. Njësitë e Qeverisjes Qendrore të përgatisin dokumentin e programit buxhetor afatmesëm të rishikuar. Ky dokument të ri-punohet mbështetur në tavanet e shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm, të miratuara me VKM nr.476/2018 si dhe, analizave e rekomandimeve të përcjella nga Ministria e Financave mbi cilësinë e dokumentit të përcjellë në fazën e parë.
2. Tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e PBA 2019-2021, janë miratuar me VKM nr.476/2018 “Për miratimin e taveve përfundimtare të shpenzimeve për PBA 2019-2021”, në nivel programi, dhe gjendet bashkëlidhur këtij udhëzimi.
3. Objektivi i fazës teknike të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021 është përpunimi i detajeve teknike të buxhetit brenda taveve përfundimtare të miratuara. Në këtë kuptim, Njësitë e Qeverisjes Qendrore nuk mund të ri-sjellin kërkesa për financimin e politikave të reja dhe kërkesa për mangësitë në financim të politikave ekzistuese.
4. Kërkesat buxhetore të njësisë së qeverisjes së qendrore, për fazën teknike do të paraqiten sipas formateve standarde bashkëlidhur këtij udhëzimi, të cilat përmbajnë:
 - a. **Formati nr.1** “Misioni i njësisë së qeverisjes qendrore”

Njësia e Qeverisjes Qendrore do të paraqes në këtë format misionin e njësisë, do të rendis të gjitha programet buxhetore dhe do të paraqes një përshkrim të shkurtër të tyre.

- b. **Formati nr.2** “Formati Standard i përgatitjes së kërkesave buxhetore 2019-2021”

Në këtë format, Njësia e Qeverisjes Qendrore do të paraqesë Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së bashku me Treguesit e Performancës, dhe Produktet e Kostot përkatëse, të rishikuara në përputhje me tavanin përfundimtar të Programit.

c. Shtojca nr.1/A

Në këtë shtojcë do të plotësohen pasqyrat e mëposhtme:

- Pasqyra nr.1 “Të ardhurat e Veta”
- Pasqyra nr.2 “Buxheti Vjetor 2019
- Pasqyra nr.2/1 “Buxheti Vjetor 2020
- Pasqyra nr.2/2 “Buxheti Vjetor 2021”
- Pasqyra nr.3 “Përmbledhësja e Pagave”
- Pasqyra nr.4 “Numri i punonjësve”
- Pasqyra nr.5 “Cash Flow”
- Pasqyra nr.6 “Investimet Publike me financim të brendshëm”
- Pasqyra nr.7 “Investimet Publike me financim të huaj”

5. Kurset e Këmbimit për vitet 2012-2018 dhe parashikimi për vitet 2019-2021, që do të përdoren në planifikimin e shpenzimeve për projektet me financim të huaj, jepen si më poshtë:

Nr	Monedhat	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
1	Kurs i këmbimit mesatar Lek/USD	108.2	105.7	105.5	126.0	124.1	119.1	119.1	119.1	119.1	119.1
2	Kurs i këmbimit mesatar Lek/EURO	139.0	140.3	140.0	139.7	137.4	134.1	134.1	134.1	134.1	134.1

6. Buxhetimi gjinor në përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2019-2021

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.465, datë 18.07.2012 “Për integrimin gjinor në Programin Buxhetor Afatmesëm” dhe të udhëzimit të përbashkët nr.21, datë 21.06.2013 “Për përcaktimin e procedurave për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm”, të gjitha ministritë e linjës brenda një ose dy programeve buxhetore përkatëse duhet të përcaktojnë objektiva të përshtatshëm e të matshëm, të detajuara në produkte/aktivitete/kosto për arritjen e barazisë gjinore. Për të realizuar me sukses buxhetimin gjinor nisur nga sa më sipër:

- Të përdoret udhëzuesi praktik “Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor”, të cilin e gjeni në link-un: <http://www.financa.gov.al/al/raportime/buxheti/udhezime>
- Konsulenti i UN WOMEN, pranë Ministrisë përgjegjëse për çështjet e buxhetimit gjinor, do të asistojë EMP e programeve në procesin e draftimit të objektivave, produkteve, dhe kostove që ndikojnë në promovimin e barazisë gjinore.

7. Afatet për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2019-2021

a) Datat kryesore të Kalendarit të Menaxhimit të Shpenzimeve Publike për vitin 2018, të detyrueshme për t’u zbatuar për qëllim të këtij Udhëzimi, janë:

- Afati për dorëzimin e Kërkesave të Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021 për **Fazën teknike, është deri më datë 31 gusht 2018;**
- Datat e seancave dëgjimore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021, për **Fazën teknike**, paraqiten në **Tabelën nr.2**, bashkëlidhur këtij Udhëzimi. Në periudhat **17 Shtator-26 Shtator**, Ministria përgjegjëse për financat do të zhvillojë seancat dëgjimore me të gjithë anëtarët e Grupeve të Menaxhimit Strategjik të Njësive të Qeverisjes Qendrore. Në këto seanca do të marrin pjesë gjithashtu, përfaqësues nga struktura përgjegjëse për planifikimin strategjik në Kryeministri dhe struktura përgjegjëse për integrimin evropian në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, si dhe një përfaqësues për çështjet gjinore nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në rolin këshillimor, gjatë të cilave do të diskutohen kërkesat për Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021 të dërguara prej tyre. Në këto seanca do të jepen konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse, sipas fushave përkatëse nga përfaqësuesit e institucioneve të sipërcituara, të cilat do të përfshihen në raportin përmbledhës të përgatitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, raport i cili u dërgohet zyrtarisht Një sive të Qeverisjes Qendrore.
- b) Ndëshkimet e parashikuara në nenin 71, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar do të zbatohen për nëpunësit autorizues në çdo rast të mundshëm të mosrespektimit të këtij udhëzimi.

8. Ndjekja e Procesit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021 dhe Mbështetja Këshillimore

- Ndjekja dhe zbatimi me përpikmëri e këtij Udhëzimi nga ana e Njësive të Qeverisjes Qendrore do të raportohet rregullisht nga ministri përgjegjës për financat në Këshillin e Ministrave.
- Të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore, krahas dorëzimit të kërkesave buxhetore në hard copy në Ministrinë përgjegjëse për financat brenda afateve të përcaktuara në këtë udhëzim, duhet t'i dërgojnë elektronikisht këto kërkesa dhe në adresën e e-mail: budget.programming@financa.gov.al.



MINISTËR
Arben Ahmetaj